

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Aricoma a.s. Republika Çeke do të fitoj kontroll mbi KCT Data
s.r.o. Republika Çeke
(lënda nr. 08-77 /2024)**

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 22.04.2024, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Aricoma a.s me seli në Vinohradaska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke do të fitojë kontroll të plotë mbi KCT Data s.r.o me seli të regjistruar në Valçikova 1369/17, Liben 182 00 Pragë 8, Republika Çeke.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Aricoma a.s. është një kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë e saj simotra - veçanërisht Aricoma Systems a.s., (i njohur më parë si Autocont AEC a.s.), Sabris Konsalting s.r.o dhe Aricoma Enterprajs Sabejsekjuriti a.s.

Aricoma Systems a.s. fokusohet në zbatimin e ndërmarrjeve të mëdha dhe projekteve të mëdha të klientëve, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit të Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturën e IT, aplikacionet e korporatave, mbështetjen e procesit të biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e IT.

Sabris Konsalting s.r.o. fokusohet në ekspertizën e SAP, zgjidhjet e biznesit dhe shërbimet përkatëse.

Aricoma Enterprajs Sabejsekjuriti a.s. ofron teknologjitë e sigurisë, vlerësimin e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes kibernetike dhe shërbimet këshillimore të GDPR/përputhshmërisë.

Aricoma a.s. i përket Grupit KKCG. Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë llotaritë dhe lojërat e fatit, energjinë, pasuritë e paluajtshme dhe teknologjitë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në treg për të punuar me терминалет e video lotarisë dhe teknologjitë e informacionit përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIA SHPK Shkup, me aktivitet prioritar - lojëra të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me aktivitet prioritar - lojërat e fatit dhe basteve;
- Kinshift SHPKNJP Shkup, më parë i njohur si Seavus SHPKNJP Shkup me aktivitet prioritar - programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për edukim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve Kinshift AKademi SHPKNJP Shkup, më parë e njohur si qendra arsimore dhe zhvillimore Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft DOOEL Shkup - me aktivitet prioritar - programim kompjuterik.

KCT Data s.r.o është një aktivitet prioritar në sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se tregu përkatës për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si tregu i shërbimeve të teknologjisë së informacionit ("IT") në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

29.04. 2024

Shkup